

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-30/018	Data: Datum: 01.02.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës 03/L-149, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.320-2, të datës 01.02.2018 të parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi, që punëtori Ramë Blakaj, me detyrat e punës Pylltar i Terrenit, të kthehet në listën e pagave dhe morri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 09 Nr.320-2, të datës 01.02.2018 e parashtruar nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi, që punëtori Ramë Blakaj të kthehet në listën e pagave nga data 01.02.2018, i cili është liruar sipas Aktgjykimin ED.nr.447/15 të datës 19.01.2018.
2. Punëtori i lartpërmendur që nga data 01.02.2018 ja fillon punës duke i kryer detyrat e punës Pylltar i Terrenit.
3. Obligohet Udhëheqësi i Personelit, Përgjegjësja për Paga, Mëditje dhe Kompensime që punëtorin e lartpërmendur të kthejë në listën e pagave sipas këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Udhëheqësi i Personelit, Përgjegjësja për Paga, Mëditje dhe Kompensime, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të Administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ramë Blakaj, Udhëheqësi i Personelit, Përgjegjësja për Paga, Mëditje dhe Kompensime, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.


Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.31/18	Data: 01.02.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) , nenit 22 paragrafi 2 pika 2.2. të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenit 19 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompenzime të tjera të Nëpunësve Civil, duke pasur parasysh se Ibish Maksutaj, Drejtor në SHFMU “ Trepça) në Banjë në Kuadër të Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë, i cili shkon në pension me datë: 04.02.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. T'i bëhet kompensimi Ibish Maksutaj, Drejtor në SHFMU “ Trepça “ në Banjë, në kuadër të Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë, në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar për shkak të pensionimit.
2. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. E këtij Vendimi do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë, nga kodi ekonomik i pagave dhe mëditje, mallra dhe shërbime apo subvencione.
3. Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. do të bëhet nga Zyrtari i Lartë për Buxhet dhe Financa pranë Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të të njëjtit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Menaxheri i Personelit dhe Zyrtari i Lartë për Buxhet dhe Financa pranë Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë.
5. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen : Ibish Maksutaj, Menaxheri i Personelit dhe Zyrtari i Lartë për Buxhet dhe Financa pranë Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.32/18	Data: 07.02.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) , nenit 22 paragrafi 2 pika 2.2. të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr.03/L-147 dhe nenit 19 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompenzime të tjera të Nëpunësve Civil, me lajmërimin nga Menaxheri i Personelit për përfundimin e shërbimit të nëpunësit civil z. Imer Balaj, titulli i postit: Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. T'i bëhet kompensimi Imer Balaj, me titull të postit: Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore në kuadër të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa , në lartësi prej një page mujore të cilën e ka realizuar për shkak të pensionimit.
2. Nëpunësit Civil të lartpërmendur i përfundon shërbimi me datë: 14.02.2018
3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.
4. Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. do të bëhet nga Përgjegjësja për Paga, Meditje dhe Kompensime, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.
5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të të njëjtit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Menaxheri i Personelit dhe Përgjegjësja për Paga, Meditje dhe Kompensime.
6. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen : Imer Balaj, Menaxheri i Personelit dhe Përgjegjësja për Paga, Meditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.34/18	Data: 08.02.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Qeverisjen Lokale " Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës "Nr.28/2008, nenit 40 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (" Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës " Nr.72/2010), nenit 8 paragrafi 1.1. dhe nenit 10 paragrafi 2. Të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Shërbyesve Civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-016-890 të datës 05.01.2018 të parashtruar nga nëpunësi civil : Besim Sylaj, Gjeometër në Drejtoratin për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, nxjerr:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET:** Kërkesa Nr.01-016-890, e datës 05.01.2018, të parashtruar nga nëpunësi civil : Besim Sylaj, Gjeometër në Drejtoratin për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, për pushim pa pagesë për një vitë duke filluar nga data 01.02.2018 deri më datën 31.01.2019 me qëllim të shërimit jashtë vendit.
- II. I përmenduri obligohet të lajmërohet në punë me: 01.02.2019, nëse nuk lajmërohet deri me këtë datë në punë, konsiderohet se e ka braktisë vendin e punës me vetë dëshirë.
- III. Obligohet Menaxheri i Personelit, përgjegjësja për Paga, Mëditje dhe Kompensime të bëjë korrigjimet në listën e pagave të punëtorëve prej muajit shkurt të këtij viti në pajtim me këtë vendim.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen : Menaxheri i Personelit dhe Përgjegjësja për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

A r s y e t i m

Besim Sylaj, nëpunës civil i caktuar në punët dhe detyrat e Gjeometrit në Drejtoratin për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit ka parashtruar kërkesë Nr.01-016-890 të datës 05.01.2018 për pushim pa pagesë për një vit, me qëllim të shërimit jashtë vendit. Kryetari shqyrtoj kërkesën e të lartpërmendurit dhe të njëjtën e miraton, duke lejuar pushim pa pagesë për një vit.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen : Besim Sylaj, Menaxheri i Personelit, Përgjegjësja për Paga, Mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
Haki Rugova

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01- Zyrtare/018	Data: Datum: 14.02.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, dhe nenit 1 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Arsim-Sektori për Kulturë, Rini dhe Sport, shqyrtoi kërkesën Nr.05-400-4497 të datës 26.12.2017 të parashtruar nga OJQ "Sporti Shkollor" për përkrahje financiare për organizimin e turnirit tradicional të shahut "UÇA 92" dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

VENDIM

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.05-400-4497 të datës 26.12.2017 e parashtruar nga OJQ "Sporti Shkollor" për përkrahje financiare për organizimin e turnirit tradicional të shahut "UÇA 92" dhe i ndahen 1,175.00 euro (njëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë euro) nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim-Sektorin e Kulturës, Rini dhe Sport, për përkujtimin e "Tre Dëshmorëve të Shkollës Shqipe".
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ "Sporti Shkollor" në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Arsim-Sektorin e Kulturës, Rini dhe Sport.
4. Vendimi është përfundimtarë

A r s y e t i m

OJQ "Sporti Shkollor" ka parashtruar kërkesën Nr.05-400-4497 të datës 26.12.2017 për përkrahje financiare për organizimin e turnirit tradicional në shah "UÇA 92" për përkujtimin e "Tre Dëshmorëve të Shkollës Shqipe".

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Për shkak të rëndësës së përkujtimit të "Tre Dëshmorëve të Shkollës Shqipe" përkrahet financiarisht OJQ "Sporti Shkollor, sipas tabelës së buxhetit për shpenzime të paraqitura në projekt propozim, për mbajtjen e turnirit tradicional të shahut, nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Arsim- Sektorin e Kulturës, Rini dhe Sport.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e OJQ "Sporti Shkollor në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të Vendimit njoftohen: OJQ "Sporti Shkollor", Drejtoria për Arsim Sektorin e Kulturës, Rini dhe Sport dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
Nr.Br.01-36/018	Data: Datum: 14.02.2018		

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), më qellim të formimit të komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin: "Organizimi i kursit të skijimit për nxënës të shkollave" dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Vlerësimin e ofertave për aktivitetin: "Organizimi i kursit të skijimit për nxënës të shkollave" dhe në Komision caktohen:

- 1). Qefsere Ibrahimaj, Përgjegjëse për Kulturë, Kryetare e komisionit;
- 2). Kenan Arifaj, Master i Edukatës Fizike, anëtar; dhe
- 3). Burim Gjoci, Profesor i Edukatës Fizike Farmaciste, anëtar;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për aktivitetin: "Organizimi i kursit të skijimit për nxënës të shkollave", të bëjë si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit dhe Zyra e prokurimit.

4. Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit Zyra e Prokurimit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01Nr.40/018	Data 20.02.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), më qëllim të formimit të grupit punues për plotësimin e Pyetësorit të Vetëvlerësimit të Kompetentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2017, nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet grupi punues për plotësimin e Pyetësorit të Vetëvlerësimit të Kompetentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2017 dhe në grupin punues caktohen:

- 1) Osman Sadikaj, ZKF, Koordinator i grupit punues dhe përgjegjës për plotësimin online të pyetësorit;
- 2) Hysni Maxharraj, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet e Financa, anëtar;
- 3) Jashar Blakaj, Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, anëtar;
- 4) Agim Haxhijaj, Drejtor i Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë, anëtar;
- 5) Anton Gegaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar;
- 6) Isa Hoxha, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar;
- 7) Demë Çeta, Drejtor i Drejtorisë për Inspeksion, anëtar;
- 8) Bedri Hasanaj, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar;
- 9) Beqir Metaj, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, anëtar;
- 10) Fatmir Bytyqi, Udhëheqës i Personelit, anëtar;
- 11) Rasim Mahmutovic, Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
- 12) Riza Alihajdaraj, Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, anëtar;
- 13) Zize Bujupi, Menaxhere e Prokurimit, anëtare;
- 14) Zekije Sutaj, Udhëheqëse e Zyrës Ligjore, anëtare;
- 15) Sanije Mavraj, Koordinatore e Zyrës Komunale për të drejta e njeriut dhe çështje gjinore mundësi të barabarta dhe persona me aftësi të kufizuara, anëtare;
- 16) Brahim Hetemaj, Udhëheqjes i Sektorit për Shëndetësi dhe Buxhet, anëtar;

- 17) Hatixhe Arifaj, Menaxhere e Tatimit në Pronë, anëtare;
- 18) Elfete Blakaj, Përgjegjëse për Mjedis, anëtare;
- 19) Sami Ferati, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, anëtar;
- 20) Jeta Balaj, Zyrtare për Informim Publik, anëtare;
- 21) Vjosa Hysenaj, Asistente Administrative e Kryesuesit të Kuvendit, anëtare;
- 22) Muhamet Gusturanaj, Udhëheqës i Sektorit për Integritet Evropian, anëtar;
- 23) Selmon Blakaj, Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile, anëtar;
- 24) Fazli Stollaj, Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, anëtar dhe
- 25) Genc Ademaj, Shef i Kabinetit të Kryetarit, anëtar.

2. Grupi punues i lartcekur ka për obligim që të kontriboj në plotësimin e Pyetësit për Vetëvlerësim të Kompetentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2017, të vlerësojnë me nota, komente dhe sugjerime.

3. Grupi punues i lartcekur, ka për obligim që Pyetësin e Vetëvlerësimit të Kompetentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2017 të plotësojë me të dhënat e nevojshme deri me datë: 28.02.2018, si dhe për punën e grupit të njoftojnë Kryetarin.

4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Koordinator i grupit punues, Përgjegjësi për plotësimin online të pyetësit dhe anëtarët e komisionit.

5. Me kopje të këtij vendimi njoftohen: Koordinator i grupit punues, Përgjegjësi për plotësimin online të pyetësit, anëtarët e grupit punues dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-39/018	Data: Datum: 20.02.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-8182 të datës 16.02.2018 e parashtruar nga Bajram Hajzeraj nga fsh. Uçë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e tij për dializë në Pejë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. MITATOHET: kërkesa Nr.06-553-8182 të datës 16.02.2018 e parashtruar nga Bajram Hajzeraj për përkrahje me karburant për dërgimin e tij për dializë në Pejë dhe i lejohet furnizimi i automjetit me nga 57 litra karburant për çdo muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurën me vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Bajram Hajzeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-8182 të datës 16.02.2018, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij për dializë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Bajrami është i sëmurë dhe ka nevojë që të dërgohet për dializë.

I lartpërmendura është i sëmurë rënd dhe nuk mund të shkoj për dializë me veturën e Qëndresë Komunale të Mjekësisë Familjare në Istog, nuk ka mjete financiare që të siguroje transportin e tij. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që ti ndihmohet që të furnizohet me karburant.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i shëndetësisë, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Bajram Hajzeraj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-41/018	Data: Datum: 23.02.2018	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 22 paragrafi 2 pika 2.4. të Ligjit për pagat e nëpunësve civil, Nr.03/L-147 dhe nenit 22 paragrafi 2. të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr:33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, shqyrtoj kërkesën Nr.01-120-9187 e datës 23.02.2018 e parashtruar nga Naser Gjocaj nga fsh. Tomoc, Komuna e Istogut, me rastin e vdekjes së prindit-nënës Cyma Gjocaj, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.01-120-9187 e datës 23.02.2018, e parashtruar nga Naser Gjocaj, me rastin e vdekjes së prindit-nënës Cyma Gjocaj, i bëhet kompensimi në lartësi prej 345€ (treqind e katër dhjetë e pesë euro), si ndihmë familjes së lartpërmendurit.
2. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim nga kategoria ekonomike e subvencione dhe transfere ose kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.
3. Pagesa e mjeteve të cekura në pikën 1. do të bëhet nga Zyrtari Përgjegjës për Paga, Mëditje dhe Kompensime në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit.
4. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, në kuadër të Administratës komunale, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Naser Gjocaj, Udhëheqësi i Personelit, Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

